



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:231565

Datë: 24.02.2024

Numri i dokumentit: 05369217

P.nr.1129/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit R.M., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK) sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2034-8/21 të datës 14.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Atnor Skoro, si dhe të akuzuarit, me datë 22.08.2022, morri dhe publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

R.M., nga i ati, e ëmae lindur, i lindur më, në Prizren, ku edhe jeton, rr. “.....”, nr....., ka të kryer shkollën fillore, punëtorë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal,

Ë S H T Ë F A J T O R

Më 31 Gusht të vitit 2021, rreth orës 22:20, në Prizren, saktësisht në rrugën “Ibrahim Rugova”, i pandehuri pa autorizim posedon substancë narkotike, ashtu që deri sa patrulla policore gjatë patrollimit ka ndaluar tre persona të cilët ishin duke lëvizur në këmbë, mesin e tyre edhe i pandehuri, ku i pandehuri në momentin që i vëren policinë, e gjuan në tokë një pako të cigareve në brendësi të së cilës kishte një (1) cigare të mbështjellë me substancë narkotike të llojit marihuanë, me sasi 0.33 gram, të cilën i pandehuri e kishte në posedim të paautorizuar dhe e njëjta i është sekuestruar si prova nga ana e policisë,-

-Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 7, 38, 39 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, 40 par. 1 pika 1.3, 43, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48 par.4, 49, 69, 70, 71 72 dhe 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074 të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqondnjëmijënjëqind) Euro, të cilën shumë i kauzuar është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmris të aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk mundet apo dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësoet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20,00 Euro nga një ditë burg, respektivisht 15 (pesëmdhjetë) ditë burg, dhe

DËNIM ME KUSHT

I vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë të re penale

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Konfiskohet substanca narkotike me peshë 0.54 gram si mjet i kryerjes të veprës penale

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2034-8/21 të datës 14.10.2022, kundër të akuzuarit R.M., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK)

Prokurori i shtetit Atnor Skoro, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr.2034-8/21 të datës 14.10.2022, kundër të akuzuarit R.M., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK) dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari R.M., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoi veprën penale e cila më vihet në barrë, sa i përket kualifikimit juridik të prokurorit të shtetit dua të shtoj që është e vërtetë që unë kam qenë konsumues i mjeteve narkotike edhe më heret, por të gjitha këto kanë qenë në sasi të vogla, andaj i propozoj gjykatës që të cekurat më lartë, pranimin e fajësisë, rrethanat e mia personale, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesëshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu edhe pendimin tim të thellë për veprën penale të kryer si dhe faktin që më e kam braktisur konsumimin e substancave narkotike, të gjitha këto rrethana gjykata ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes të vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike;

Më 31 Gusht të vitit 2021, rreth orës 22:20, në Prizren, saktësisht në rrugën “Ibrahim Rugova”, i pandehuri pa autorizim posedon substancë narkotike, ashtu që deri sa patrulla policore gjatë patrollimit ka ndaluar tre persona të cilët ishin duke lëvizur në këmbë, mesin e tyre edhe i pandehuri, ku i pandehuri në momentin që i vëren policinë, e gjuan në tokë një pako te cigareve në brendësi të së cilës kishte një (1) cigare të mbështjellë me substancë narkotike të llojit marihuanë, me sasi 0.33 gram, të cilën i pandehuri e kishte në posedim të paautorizuar dhe e njëjta i është sekuestruar si prova nga ana e policisë,-

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074.

Me rastin e marrjes së vendimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 të KPRK gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, kërkim falja publike para gjykatës, andaj gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqondnjëmijënjëqind) Euro, të cilën shumë i kauzuarit është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmris të aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk mundet apo dënimin i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësoet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20,00 Euro nga një ditë burg, respektivisht 15 (pesëmdhjetë) ditë burg, dhe i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër të re penale, sepse konsideron se me këtë lartësi dhe lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimin i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më i kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK -së.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit gjykata e bazoi në kuptim të nenit 282 par.2 nën par.2.4 të KPPK

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1129/2021 me datë 22.08.2022

Procesmbajtësja
Nacis Sarani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.